

Procesverbal

Nga Mbledhja VI (e gjashtë) e rregullt për vitin 2025 e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më datë: 27.06.2025

Rend Dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për seancën e gjashtë të rregullt; dhe
3. Eventuale.

Arijeta Skeraj: Përshëndetje kryetar, kolegë, përfaqësues i OSBE-së! Mirë se keni ardhë në Mbledhjen e gjashtë të rregullt të KPF-së për vitin 2025! Materialin besoj që e keni pranuar të gjithë! Para se ta hedhim në votim, a do dikush me e marrë fjalën rreth rendit të ditës? Në qoftë se jo, e hedhim në votim. Kush është pro këtij rendi të ditës? A ka kundër? Abstenim? Me 5 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë rendin e ditës. Vazhdojmë me pikën e parë: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, e hedhim në votim. Kush është pro miratimit të procesverbalit? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë pikën e parë. Vazhdojmë me materialin e seancës, pika e dytë: Miratimi i KAB për vitin 2026-2028. A do dikush me e marrë fjalën rreth kësaj pike?

Artan Loshaj: Mirëmëngjesi për të gjithë! Kryetar, me këtë Listën e shpenzimeve 2026-2028, shumë shkurt sot me ty, se të hënën pak ma tepër. Na pate premtue që deri në fund të mandatit tënd, qeky Ujësjiellësi shumë i famshëm i 15 fshatrave, po bëhet. Na ke akuzue që 10 vjet s'un e kemi ndreq. Po e shoh që për 2026-tën i ke qit 400 mijë euro. Në 2027-tën 2 milionë e 300 mijë, edhe më 2028 afër 3 milionë. Në rregull! Kur do të ndreqet qeky uji, a do të ndreqet, a mandatin qetor, si ta marrish? Se kie me e zgat ma shumë se PDK-ja. Edhe po më intereson, rreth këtij ujësjiellësi, disa delegatë – po due me e ditë, se ke ardhë vonë si kryetar i Komunës, na disa delegatë që jemi më të vjetër këtu, po më intereson qysh është gjendja e këtij ujit, se ma herët një firmës na ia kemi dhënë për shfrytëzim këtë ujin. Tash po ia marrim. Kam ndie që ajo firma do me ju akuzue – si Komunë, jo si kryetar – edhe ato paret janë bajagi do pare shumë që ka shti ai aty – ka me e padit Komunën edhe ka me i lyp me i kthye prapë investimet, edhe për 20 vjet atë fitimin ka me e qit në laps edhe ka me e penalizue Komunën. Nashta s'e fiton në gjyq, po në gjyq ka me shkue kjo lëndë. Shkojmë më poshtë – ndërtimi i deponive të ngurta në Orqushë dhe Rrenc. Kryetar, këtë edhe herën e parë e kam kundërshtuar, kam bisedue me qytetarët, prapë janë të pakënaqur qytetarët e fshatit Rrenc që jo deponi të bëhet aty. E vetmja mundësi që kam kërkue unë, edhe në qoftë se bëhet – kam qenë kundër – por edhe në qoftë se bëhet, rruga të çelet nga rruga e vjetër e Pllavës, jo të futen nëpër Rrenc kamionat me peshatë rënda, rruga është e ngushtë. Qytetarët janë kundër, edhe prapë deri në shtator do të shkon në finale kjo, duhet me kqyr, se aty nuk mundim me bo veç deponi të ngurta, po aty afër Rrencit, mundin me ardhë edhe deponitë tjera me i pru, për shembull si në Zhur qysh e kemi. Aty është për të ngurta, po e dini shumë mirë, se me siguri kalojsh ma shumë se unë aty, s'mundet me u kalue prej erës. Numër katër qetu – Ndërtimi i kulmve të ndërtesave në qytezën e Dragashit – shumë mirë, po këto pare janë shumë pak, kryetar. Ndërtesat me 60 mijë euro me i ndreq kulmat, s'po e besoj që... në qoftë se ka mundësi pak më tepër me e rrit. Edhe, një kërkesë e imja është: këtë ndriçimin publik që po e bëjsh për fshatrat, 3-2-1 që po ja boni, është mirë edhe atë që po e boni, po qeto ndërtesat, nja 10 ndërtesat që janë e kanë vendin, edhe orën e kanë krejt i kanë, për ndriçimin brenda ndërtesës. Me 10 mijë euro mundesh 10 ndërtesa, me pas parasysht me e bo, e kemi orën aty, masi edhe Komuna po e paguan rrymën fshatrave, është mirë, ora është aty, veç me i vu do drita, me e bo njëfarë mirëmbajtje të asaj. Ta kam thënë edhe ma herët, jo qetash për fushatë. Nuk ta kam thënë veç sot, që është afër fushata, ta kam thënë edhe vitin e kaluar edhe ta kam pru shembull Komunën e Prishtinës, qysh e ka marrë menaxhimin e ndërtesave të vjetra. Shkojmë më

poshtë, qetu – Ndërtimi i kanalizimit dhe ujësjellësit në Kapre – 17 mijë euro. E kam parë Pllajnikun, Buqen, Zymin, Buzezin, Rrencin, ke qit shifra të mira këtu, është mirë. Kaprja edhe Xërxa me ka 15 mijë euro, mos është pak! Është mirë ndonjë shumë këtyre, bare dhe ka nja 10 mijë euro me jau shtue, se me siguri e ke bo hesap, s’ka shumë vota aty, edhe... a qaq duhen? Në rregull, ti po thuesh qaq, unë po them duhet ma shumë, po ti prapë 17 mijë euro, në rregull, po thuesh qashtu, mirë është. Edhe numër 38 e kemi: Ndërtimi i murit mbrojtës te varrezat dhe kubëzimi i fshatit Rrenc. Janë 68 mijë euro. Ne i kemi tri varreza në fshatin Rrenc. A ka mundësi me e ditë, te cilat varreza? Në qoftë se e ke fjalën ato varrezat nalt, që kompania e cila e ka hap rrugën dhe ka bo dëme në fshat, ajo është e pamoralshme edhe kanë me e kundërshtue me petition qytetarët. Jo me i marrë paratë e fshatit Rrenc, me investue në atë murin mbrojtës. Këtu duhet me reague edhe kryesuesja, si kryesuese dhe si delegate e Rrencit, po s’po due me hy në debate shumë me të, duhet me reague fuqishëm, për arsye se aty nuk është problemi i fshatit që duhet me e ndreq atë mur mbrojtës. Aty është problemi që kompania ka bo dëm, edhe mbikëqyrësi yt që e ka lejue atë, edhe ai duhet me u dënue. Paratë e fshatit Rrenc, që i takojnë qytetarëve të fshatit Rrenc, nuk duhet me i marrë aty 20-30 mijë a 40 mijë euro, me i harxhue pse ajo firma e njofshme e juaja – shoki juaj a çka e kini – me i marrë ato parat. Të lutem, me ma dhënë një shpjegim për cilët varreza bëhet fjalë. Jemi kategorik kundër këtij investimi. Jo si investim, po të kthehet – se na ke premtue qe dy vite – 2023’tën të kam thënë, më ke thënë në 2024’tën, në 2024’tën më ke thënë në 2025’tën do ta bëjmë. Më ke premtue murin mbrojtës, publikisht e ke qetu, murin mbrojtës do ta bëjmë vitin e ardhshëm. Ama me parat e fshatit Rrenc jo. Ato – edhe një herë po të them – me parat e investitorit i cili i ka bo ato gabime aty. Kategorik jemi kundër që parat e fshatit të merren për atë murin mbrojtës me e bo. Se këtu, prej kësaj foltores menjëherë del Artani është kundër varrezave me i ndreq, murin mbrojtës. Jo, murin mbrojtës keni me e ndreq me parat të Komunës ose me parat të asaj firmës atje. Edhe qetu në fund e pashë – nashta këta të minoritetit, mësuesi Behar e ka bo me qëllim – edhe numë 57, edhe numër 64 njëjti projekt është – Ndërtimi i terreneve sportive në fshatin Libevishtë, 30 mijë euro – edhe 64 prapë – Ndërtimi i terreneve sportive në Libevishtë, 40 mijë euro. Domethënë, dy projekte, 70 mijë euro. Numër 57 edhe numër 64. Faleminderit!

Munir Jonuzi: Në përputhje me shqyrtimin e delegatëve për këtë draft-buxhet për vitin 2026, sot kam vetëm një pyetje që lidhet me fshatin Ljubavishtë. Ndërtimi i terreneve sportive në Ljubavishtë është 40.000 euro. Më intereson pse ky projekt nuk është përfshirë në kodin për kulturë, rini dhe sport. Nëse e shikojmë atë kod, shohim ndërtimin e stadiumeve në fshatrat Blaç, Plav dhe Restelicë. Ndërtimi i stadiumeve në fshatrat Blaç dhe Plav kap shumë prej 180.000 eurove. Për fshatin Restelicë janë 60.000 euro. Nëse e shikojmë raportin proporcional mes komunitetit shumicë dhe joshumicë, arrijmë në një raport prej 180.000 me 60.000, pra 1 me 3.000. Pyetja ime është pse ndërtimi i terrenit sportiv në Ljubavishtë nuk është përfshirë te kultura, rinia dhe sporti, dhe pse, për shembull, për Ljubavishtën janë ndarë mjete shtesë për ndonjë projekt tjetër infrastrukturor. Në këtë mënyrë, le të themi, 40.000 nëse do të ishin vendosur te kultura, rinia dhe sporti, do të bëheshin gjithsej 100.000. Edhe pse 180.000 me 100.000 prapë nuk do të ishte raport i barabartë, të paktën do të ishte në disa kufij normalë. Gjithashtu, më intereson edhe projekti që lidhet me fshatin tim, ndërtimi i një kanali (potok) në rrugën Rumanicë në fshatin Rapçë. Kjo Rumanicë përmendet vazhdimisht, zoti kryetar, kryesuese dhe drejtor, drejtori i financave nuk është këtu, por kushdo që e shkruan këtë buxhet, kushdo që e krijon një buxhet të tillë dhe e lë jashtë Rumanicën, sepse në atë vendbanim jetoj unë, unë mendoj se kjo është bërë me qëllim kundër meje. Katër vite me radhë kemi projekte të vazhdueshme në fshatin Rumanicë, të cilat asnjëherë nuk realizohen dhe nuk ka asgjë për t’u realizuar atje, por kur banorët e fshatit Rapçë e shohin që përmendet Rumanica, Rumanica çdo vit, atëherë çfarë ndodh? Ndodh që thonë se vetëm unë po punoj për fshatin tim. E në këto katër vitet e fundit nuk është bërë asgjë atje.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se nuk ka, atëherë kryetari i Komunës e ka fjalën.

Bexhet Xheladini: E nderuar kryesuese, të nderuar asambleistë, anëtarë të KPF-së! Ju përshëndes dhe ju dëshiroj punë të mbarë! Lidhur me pyetjet që i parashtrori z.Artan Loshaj, sa i përket Ujësjiellit, ne planifikojmë që Ujësjielli të përfundojë këtë vit, ndërsa mjetet që i përmendet, që janë të planifikuara për vitin e ardhshëm, ato janë mjete të cilat i ka marrë përmbaruesi vitin e kaluar nga projekti i Ujësjiellit. Dhe, aq mjete ne duhet t'ua kompenzojmë kompanive, mbi 400 mijë euro i kemi borxh. Unë shpresoj që projekti i Ujësjiellit do të përfundojë këtë vit. Kemi pas pak probleme vitin e kaluar, për shkak të buxhetit, për shkak se na është marrë nga përmbaruesi afër gjysmë milion euro nga ky projekt. Dhe, kompanitë normal që nuk kanë dashtë me punue pa pagesë. Sa i përket asaj që thate ka me u penalizue Komuna për Ujësjiellin, nuk e di unë me kënd je ti, a je me Komunën, a me atë kompaninë? Edhe, nëse të bëhet qefit ty që me u pengue Ujësjielli, atëherë puno për kompaninë edhe nuk është problem. Për deponitë e ngurta, e di sh, Asambleja Komunale e ka pru vendimin, i ka caktue dy lokacione. Ne përveç që kemi konkurrue në projektet e BE-së sa i përket bashkëpunimit ndërkuftar, përmes Programit IPA, ne kemi paraparë edhe mjete, nëse dështon ai projekt, kemi paraparë mjete edhe nga buxheti ynë, që këto dy deponi të ngurta, është momenti i fundit që Komuna t'i ketë deponitë e ngurta. Unë pak para mbledhjes pata një ankesë prej një qytetari, që kompanitë ndërtoese po i hedhin mbeturinat kudo, edhe nëpër lumenj, edhe po i zënë edhe lumenjtë, edhe për atë edhe po kemi edhe shumë herë edhe vërshime që po bëjnë shumë dëme. Kështu që, sa i përket ndërtimit të deponisë në fshatin Rrenc, këtë ju e dini, kjo deponi ka qenë e paraparë me PZhK. Ju e keni miratuar, ke qenë ndoshta, a s'ke qenë asambleist, nuk e di. Por, në PZhK është e paraparë që deponia të ndërtohet aty dhe, në bazë të asaj, ne e kemi nxjerrë edhe Asambleja vitin e kaluar e ka miratuar. Ajo nuk është tokë e Rrencit, por ka qenë tokë e Pylltarisë, dhe Qeveria e Kosovës neve na ka dhënë atë tokë, edhe në Rrenc edhe në Orqushë. Dhe, nëse do Zoti edhe nëse shkojnë punët ashtu siç janë planifikuar, do t'i ndërtojmë këto dy deponi, do të luftojmë që Komuna e Dragashit të jetë një ambient i pastër sa i përket hedhjes së mbeturinave. Sa i përket rrugës, nuk është problem, ne mundemi me u marrë vesh me qytetarët e fshatit dhe rrugën mundemi me e ndreq ashtu siç iu konvenon edhe fshatarëve, edhe Komunës, e gjejmë një gjuhë të përbashkët. Unë e di që edhe fshati Rrenc nuk është kundër ndërtimit të këtyre deponive, sepse ato duhet të ndërtohen diku në territorin e Komunës së Dragashit. Ato nuk mund të ndërtohen në Hënë, ose ndonjë planet tjetër. Sa i përket murit mbrojtës, ne kemi paraparë mjete të mjaftueshme që të ndërtohet muri mbrojtës te varrezat, aty ku varrezat janë shumë të rrezikuara. Një herë, prioritet do të jetë muri mbrojtës te varrezat ku janë të rrezikuara. Ka mjete ma shumë se që duhet, mjetet tjera do të shfrytëzohen për kubëzimin e disa rrugëve të cilat kanë mbet pa u kubëzuar. Sa i përket pyejtes së z.Munirit, për ndarjen e drejtë financiare, ajo është bërë në bazë të mjeteve që i ka paraparë Qeveria për investime kapitale. Qeveria e Kosovës ka ndarë mjete financiare vetëm për arsim – 60 mijë apo 80 mijë euro – kurse mjete për kulturë nuk ka paraparë fare. Kështu që, pse ZKF-ja këto mjete të Libevishtit nuk i ka qit te kultura, është një gabim, ato duhet të qiten. Përndryshe, ndarja e drejtë financiare është bërë 40% me 60%, për të gjitha projektet kapitale. Nëse eventualisht ka ndonjë gabim, ne kemi kohë deri në shtator këtë me e përmirësue. Edhe unë jam zbatues i ligjit dhe zbatues i kërkesës për ndarjen e drejtë financiare. Sa u përket emrave të projekteve, ka gabime në emërtimin e tyre, sepse programi i Exelit që kur i shkrun tri fjalë, pastaj e qet emrin e projektit të vjetër. Aty nuk është vetëm gabimi te ju, te Rapç, po është gabimi edhe në disa vende tjera, kështu që këto mujm me i përmirësue, nëse doni edhe të hënë, por mujm me i përmirësue edhe në shtator. Është çështje e juaja, nëse doni, mundeni me dalë me propozime, unë jam për dhe do të kërkoj nga asambleistët që këto gabime që janë bërë në emërtimin e projekteve, të përmirësohen ose të hënë, ose para miratimit të buxhetit në shtator.

Artan Loshaj: Këtë politikën e juaj, kryetar, për me akuzue, e keni në gjak, e kam të njofshme, se shumë gjatë jam në politikë. Problemi te Ujësjielli është, që thaje këtë vit nuk ka punue pa i pague dhe kemi ngec, qysh do të punojnë këtë vit e në vitin tjetër me i marrë paret? A pse është vit zgjedhor, a po? S'është e juaja, është e jona, e krejtve është. Se ti thaje nuk kanë punue për pare. Sivjet po punojnë për pare, e në mot me jau dhënë se janë zgjedhjet. A kanë pranue? Vjet s'kanë pranue, e sivjet po. Po ku po e dinë sivjet a janë të sigurt? Nejsë! E dyta, sa për te penalizimi që më thaje a je ma ata, a je me

Komunën, kjo është fjalë e rëndë për ty, ndaj meje. Kërkush nuk është kundër Ujësjetës. Asambleistët e tu, në udhëheqjen e PDK-së, të parët kanë qenë ata që e kanë dhënë lejen për me i marrë këto beneficione ata. Edhe të parët kanë qenë ata asambleistët e tu, të LDK-së, që kanë shëtit nëpër botë edhe Evropë. Edhe tash mu më akuzosh, më thuesh ti a je me ata, a me këta. Unë nuk kam thënë kurgjo, unë kam thënë kam njohuri, kam lajme që je në bisedime me ta, kie presion prej tyre ti, edhe Uzairi, se ka investue njeri. Lejen e ka për 20 vite, asambleistët e tu e kanë dhënë, bashkë me qeverisjen e PDK-së. Nuk po e amnestoj unë PDK-në. E tash ata e kanë një marrëveshje me ju. Në qoftë se nuk kalon kjo, ata kanë me shkue me ju akuzue. Unë nuk thashë që ata do ta fitojnë, edhe unë jam për Ujësjetësin, se unë vetë kam me pi ujë aty. Se marrja e Zotit, 1500 metër lartësi mbidetare, unë e pi ujin e blerë. Atë ti e dish shumë mirë, edhe ti e dish se unë këso informata marr shumë shpesh. Krejt t'i ka bo ai 'bubi i Gospoxhes', ai baca Uzair, që e ke afër vetes. Ai t'i ka pru këto, se ai i ka bo këto manipulime në kuadër të PDK-së, prapë është duke t'i bo, edhe prapë ka me t'lënë në lloç, qysh na ka lënë neve. Bashkë me mësuesin Behar, po për atë në eventuale kam me bisedue. Shkojmë më tutje: te deponia që po thuesh na e kemi votue. Po! Fshati Rrenc është kundër. Ti mundesh me e bo, unë e di edhe pse. Se kanë ardhë dy-tre veta me e lyp një vend pune aty – bone një vend atje, ma merr djalin në punë, bone. Unë këto unë i di shumë mirë. Po, po, kryetar, kqyre, për politikë katër vjet i kie, se njëzet vjet ke pazue. Asnjë troh nuk është rrenë. Të lutem, kryetar, nuk të ndërpreva! Këtu dalish në foltore ma thuesh. Nuk të kalon nëpër Rrenc, ti e dish shumë mirë që peticion kanë me pru. Ti mundesh me e bo, se i kie votat, i kie gishtat. Por, unë po të them se nuk është mirë me e bo në Rrenc, se nuk kalon në Rrenc. Ta bojsh ti deponinë 500 metër vijë ajrore me fshatin, edhe ti e dish shumë mirë që çfarë menaxhimi kie këtu me inspektorat, kush është ai burrë që del i ndalë mbeturinat, përveç të ngurtave me i qit aty. Bëhet depni që kundërmon jo Rrenci, po kundërmon krejt Opoja. Me kamionat, qysh i kanë këto firmat e mëdha, prej Zaplluxhes e në Restelicë, me kap me i çue te Ura e Haxhi Musës në Rrenc, me e prish asfaltin, me bo aksidente, nuk të kalon, kryetar. Ti mundesh me e bo. Unë kam me u mundue me çdo mënyrë, me çdo send me kundërshtue, se ti je i fortë, se ti je i pari i Komunës, i kie gishtat, po e kie gabim. Sa për te kubëzimi, në fshatin Rrenc – unë ta kam thënë, se vij nga Rrenci – jo me kubëza që po e shtroni rrugën deri nëpër shpia private, e që kur të shkoni nëpër piknike, ju keni deretue edhe familjarëve tuaj kubëzat. Nuk është problem, nuk jam kundër, se ju thoni Artani ka dalë në Komitet ka folë, është kundër kubëzimit. Jo! Në Rrenc, rrugë publike nuk ka me kubëzue, as këtë vit s'ka pas, as vitin tjetër nuk ka. Po, ka shpia, masi ia keni nis me i ndreq, mirë. Për në mot edhe unë jam, se ke fillue nëpër shpia, masi ke fillue nëpër shpia, do ta vazhdosh deri në fund nëpër shpia. Në Rrenc, shpi nuk ka mbet pa kubëzue rrugë publike. Tash nëpër shpia që ke bo për një grusht vota, që ke shkue "çile derën, mshile derën, ec, në rregull jemi", ato një ditë do të dalin. Nuk jam kundër, e ke vazhdue, vazhdo deri në fund. 68 mijë janë pak me i shtrur kubëzat nëpër Rrenc. Për te varrezat, unë vij nga fshati Rrenc, tri varreza i kemi aty, tri mahallë i kemi. Mahalla posht, mahalla e mesit, nuk ka nevojë për mur mbrojtës – është mirë me i rrethakue ato varrezat nga kafshët, shumë në rregull jemi. Sa që pretendon ti, muri mbrojtës – prapë po ta them – nalt, te varrezat nalt, ku është bo dëmtimi nga kompania, që i çon ato pare, e kie gabim. Fshatit Rrenc mos ia merr investimin 68 mijë i ka fshati, i investon në fshat, e jo në ato gabimet, ata shokët e tu ku i kanë bo gabimet, e me i përmirësue me paratë e qytetarëve. Gabim e ke, kryetar!

Munir Jonuzi: Më lejoni të bëjë një pyetje: pse nuk kemi një shumë për ndërtimin e shtëpive për personat me nevoja të veçanta? Pse nuk kemi ndonjë shumë? Të paktën në versionin në gjuhën boshnjake nuk kemi një shumë të saktë. Nuk kemi asnjë shumë të mjeteve që do të ndahen për këtë projekt. Ndërtimi i shtëpive për personat me nevoja të veçanta. A është kjo një gabim gjatë shkrimit apo me të vërtetë nuk kemi? Nuk e di si është në versionin në gjuhën shqipe. Dale, sa e kuptova mirë, ju thatë se Ministria kërkon ndarjen proporcionale në arsim. A e dini që raporti i investimeve kapitale në arsim është 74 ndaj 26%? Si është ndarë? Nga unë? Mirë. Zoti kryetar, 180.500 euro për bashkëfinancimin e projekteve me donatorët MALSA. Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe MALSA. Në kodin 42 janë ndarë 180.500 euro. Për çfarë projekti bëhet fjalë? Për çfarë shumeje bëhet fjalë? Për cilat projekte të përbashkëta? Kodi 42.

Bexhet Xheladini: Sa i përket ndarjes së drejtë, 4 milionë euro ndahet në mënyrë proporcionale, 40% më 60%. Ndërsa, është çështje e komunitetit joshumicë që këto mjete – 1.5 milionë apo sa i bjer 40%’shi – është çështje e tyre tash ku i orientojnë. Munden krejt me i orientue në arsim. Munden krejt me i orientue në kulturë. Munden krejt me i orientue në infrastrukturë. Është çështje e juaja ku i orientoni ato. Kështu që, në këtë moment ka ardhë propozimi kështu qysh është. Disa mjete janë orientue në arsim, disa në shëndetësi, disa në kulturë. Po, është problemi që mjetet që janë orientue në kulturë nuk kanë dalë në tabelën e DKRS-së, por i ka mbajtur ato mjete me i menaxhë Drejtorati i Urbanizmit. Edhe ajo është çështje e juaja, nëse doni me i menaxhë Drejtorati i Urbanizmit, ngelin ato mjete aty nëse doni me i qit në DKRS, mundeni me i qit. Por, është me rëndësi shuma totale mos me qenë më pak se 40%. Sa i përket subfinancimit të projekteve të projekteve me donatorë, ju e dini se në vitin e kaluar kemi nënshkruar një marrëveshje me KEDS-in, për ndërtimin e lartpërçuesit në drejtimin Restelicë edhe Brod. Është projekt dyvjeçar, Vitin e kaluar, me mjetet e komuniteti joshumicë, është lidhë një marrëveshje. Kështu që, ne i kemi mbetur borxh që vitin e ardhshëm, edhe 180 mijë euro duhet t’ia paguajmë KEDS-it për me përfundue, sepse projekti kushton diku afër 700 e diçka mijë euro. Ndërsa, 50 mijë euro janë mjete të përbashkëta, edhe të juajat, edhe tonat. Tash, nëse gjatë vitit të ardhshëm do të kemi donatorë, investitorë, që do të financojnë ndonjë projekt tonin, me këto mjete ne bëjmë subfinancim, apo bashkëfinancim. Këto janë, pra, 50 mijëshi janë mjete të përbashkëta, kurse 180 mijëshi janë mjete të komunitetit joshumicë.

Munir Jonuzi: Kolege dhe zëvendës-kryesuese, mund t’ju them se kolegu Sejdilar ka të plotë të drejtë të flasë nga kjo foltore. Ai mund të marrë pjesë në debat, por nuk mund të votojë në këtë komitet. Faleminderit, zotëri kryetar, për përgjigjen. 180.500 euro, sa kam kuptuar, janë ndarë për rregullimin e rrjetit elektrik. Ky është një projekt, një kontratë për linjën e tensionit të lartë që ju e keni nënshkruar. Pse atëherë nuk i përkufizojmë gjërat në mënyrë të saktë? Pse përmendim aty Ministrinë e Zhvillimit Rajonal dhe Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale? Nëse të gjitha mjetet shkojnë për rinovimin e linjës së tensionit të lartë, pse nuk shkruajmë bashkëfinancim projektesh me KEDS-in? Për të mos ngatërruar qytetarët. Ndryshe, është i ligjshëm sepse KEDS nuk i përket as Ministrisë së Zhvillimit Rajonal e as Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale. Vitin e kaluar e kishim të përcaktuar kështu dhe kam dëgjuar që nuk është ligjore. Nuk është ligjore që ne ndajmë mjete për KEDS-in, por aty shkruajmë që janë për Ministrinë e Zhvillimit Rajonal dhe Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale. Një pyetje tjetër: a do të jenë këto mjete të mjaftueshme për përfundimin e linjës së tensionit të lartë dhe zgjidhjen e problemit me energjinë elektrike? Faleminderit.

Bexhet Xheladini: Sufinancimi i projekteve me donatorë është një kod buxhetor, nuk janë dy kode. Për atë qiten me një vend. Po duhet me u shënue këtu, se zakonisht ne bëjmë sufinancime më shumë me MAPL-në – sepse do të jemi tash prapë fitues të Grantit të Performancës, dhe kjo kërkon që Komuna duhet të sufinancojë me projektet. Sepse i kemi arritur edhe këtë vit të gjitha kriteret për me e fitue prapë Grantin e Performancës dhe dje e kemi bërë konkurrimin. Gjithaashtu, edhe Ministria e Zhvillimit Rajonal që katër vite ndan mjete financiare për projektet e Komunës sonë, që duhet ta falënderoj publikisht ministrin, i cili që katër vite për Komunën tonë ndan mjete për projekte të ndryshme. Edhe këtë vit kemi nënshkruar një marrëveshje në vlerë 150 mijë euro, dhe, nëse këtë projekt ne e kryejmë brenda vitit, ka premtime që edhe mjetet e Komunës të cilat ne duhet t’i sufinancojmë, do t’i paguajnë ata. Kështu që, të hënën, te ky kod buxhetor, sufinancimi i projektit, ne mundemi me e shënue emrin e projektit, dhe sufinancimi i projekteve me ministrinë gjegjëse. Kështu që, edhe kjo përmirësohet. Por, vetëm duhet të gjitha këto mjete me i qit me një vend, sepse është një kod buxhetor në bazë të të cilit ne kemi të drejtë pastaj me lidhë marrëveshje sufinancimi me donatorë. Kjo është vërejtje me vend dhe duhet me u pranue, vetëm duhet me u plotësue emri, që një pjesë ka me shkue për bashkëfinancim me KEDS-in, dhe prej mjeteve të tjera me donatorë të ndryshëm. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit, kryetar! Nedžmidin, ti e ke Komitetin për Komunitete, edhe aty mundesh

me e marrë fjalën. A do dikush rreth kësaj pike me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 3 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë këtë pikë. Vazhdojmë me pikën e dytë. Miratimi i Listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në territorin e Komunës së Dragashit. A do dikush me e marrë fjalën rreth kësaj pike? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 3 vota pro, 2 kundër dhe 1 abstenim, e kalojmë edhe këtë pikë. Atëherë, vazhdojmë te pika e tretë, pika eventuale.

Artan Loshaj: Në eventuale e lashë, kryetar, thashë mos të bëjmë shumë replikë. Dashta me të pyet, rruga Dragash-Stadium që jeni t'u e marue, kalova një ditë, se dal e luj najherë futboll, po e shoh rrugën në gjendje të mjerueshme. Rruga Dragash-KFOR'i Turk-Stadion, në gjendje shumë të mjerueshme, i kam bo edhe do foto. Shëtitorja, në mes të shëtitores banderi. Dy: hala pa fillue, pa e pre shiritin të është zënë kanali. Uji del në rrugë. Kjo foto live është. Kanalizimi rreth rrugës Dragash-Stadium, një. Tjetri njëjtë, kqyre cevati qysh i keni lënë. Kanalizimi tjetër, dy që i ke bo, edhe ky u zënë prej gurëve dhe prej dheut. Hala s'e ke pre shiritin. Kqyre banderi ku po rri, si lejleku. Nuk është t'u rrit në dhe ai, kqyre ku është t'u rrit, është t'u rrit veç me një copë beton. Qe ku e ke, live e ke! Seriozisht po të them, qe ku është t'u rrit! Po, s'ka problem, t'i dërgoj po s'e di a ta kam numrin, duhet me ta marrë numrin. Seriozisht, betoni nuk është kërkah, është t'u rrit për marre të Zotit. Nejse, qeshnu, se është për t'u qeshur. Tjetra, për 2026-tën nuk pashë, kryetar, do stadiume i pashë qetu, po s'dashta se pale thashë kryesuesja e po ma jep fjalën dy-tri herë për një pikë të rendit të ditës. Qetu në fund e pashë – Kulturë, Rini dhe Sport: Ndërtimi i stadionit në fshatin Blaç, 70 mijë euro. Vitin e parë i ke ndarë 50 mijë euro, tri vjet ke pauzue, qetash në fund që janë zgjedhjet, hajt një troh, 70 mijë euro për stadionin e famshëm të Blaçit. Shkojmë ma poshtë – Ndërtimi i stadionit në Restelicë, në rregull, edhe në Pllavë, shumë mirë. Po në eventuale kam të drejtë me folë, qe ku po due me dalë unë. Zhveshtorja është në gjendje të mjerueshme, e ke pa. Edhe zhveshtoren ta çoj në foto. Brenda, uji është mbi gju. Kam hi një ditë me djalin me lujt futboll, ujë është e mbushr krejt ajo. Bajagi na ke akuzue në 2021-tën në fushatë atje, kundër kandidatit tonë. Katër vjet i bone! Tjetra, po shkojmë ma poshtë, due prej kryesueses me ma dhënë një informatë deri të hënë. Një vendim i fabrikës së kromit, që kemi marrë vendim, a kemi marrë vendim të përkohshëm për mos me bo investime, apo është vendim për mos me pranue mo të njëjtin material pas 3-4-5-6 muajve, pasi t'i kryni zgjedhjet. Jo, s'është urgjente sot, të hënë po due me e pa. Në qoftë se është vendim i përkohshëm, kam informata që keni prit - se e di që keni me i fitue zgjedhjet, jau kam urue para një muaji – e kam marrë vesh që mas zgjedhjeve, si të fitosh në dhjetor, kah janari me iu thënë atyre hajde edhe një herë, bone kërkesën edhe ta japim. Mirë, e jemja është si opozitë me ta thënë, ti del e ma demanto. Nuk është e ulët, kryetar, për ty është e ulët. Ne këtu kemi kërkue – sikur për centralet – që mos me pru, mos me pranue Kuvendi, edhe kryesuesja edhe kryetari, qasi kërkesa. E ju atë ditë e keni qit propozimin e Suada Bajramit, jo propozimin e disa delegatëve të opozitës, që mos me pru mo kesi dokumente. Po keni shkue në Shajne, e keni bo shumë të madhe, që ju shpëtimtarët – e dini atë, s'po due me hi. Jo, se unë nuk due për fushatë, o kryetar. S'e kam për fushatë sikur ju unë. Me kap me 20 mijë euro me bo investim, 3-2-1 edhe m'i dhezë dritat. Unë votat i kam, o kryetar. Nuk më duhen mu me dalë në foltore, bile atje s'dal me folë hiç unë. Faleminderit shumë për respektin! Nuk më duhen votat mu. Unë votat i kam bo, nëse i kam bo, i kam bo deri më sot. Natën e Bajramit kurbanu nuk trashet. S'kam nevojë për vota, unë po due me ta thënë me e ditë. Se me e ditë qytetarët sa foli unë, 1 mijë vota duhet me m'i dhënë. Pastaj po due me e ditë te nepotizmi qysh i keni punët, a ju ka mbet edhe ndonjë familjar pa u punësue? Qetu po më intereson shumë. Jo kryetar, për atë mo keni me i punësue edhe ata që keni të drejtë me u martue mas 4-5 shokë, që i thojnë mundish me i marrë edhe për nuse ose për burrë. Familjarët e ngushtë të juajit, për katër vjet, kryetar, për Zotin, sa 14 vjet PDK-ja, ia keni shkue hujin. Qetash edhe do konkurse po presim, ta shohim edhe kush janë, a keni mo, a ju ka mbet dikush. Po shkojmë ma poshtë, po due me e pyet kryetarin për në Kërstec, në shkollën e Kërstecit, në gjuhën boshnjake – është Muniri këtu – sa nxënës ka shkolla në Kërstec, në paralele, edhe sa familjarë të Uzair Hamzës janë të punësuar aty? Edhe a i kanë diplomat, se nashta qetash e ka marrë vajza e Uzairit diplomën, veç kur e kanë ndërrue prej vajzës në vajzë, me siguri nuk

e ka pas diplomën. Hala janë duke u shkollue atje, edhe nusja është duke u shkollue hala në privat, edhe i keni shti në punë – atij “bubit të gospothes”. Tjetra, ma poshtë po shojmë, te drjetori i famshëm i yti, që e ke për zemër, mësuesi Behar. Mësuesi Behar u bo edhe mjek specialist – që e kam foto, kam me ta çue, me çantë që po vjen në punë, me çantë të Urgjencës, ta çoj foton, edhe i thotë drejtorit U.D., i thotë s’ke nevojë ti këtu, se lë që u bo ai në Urbanizëm, le që u bo në punësim e në kanalizime, e në kubëzim, tash u bo edhe mjek specialist. Vjen në spital, ditën e diel, në punë, shoferi nga Krusheva, me teknikun vijnë në punë me kerr të spitalit. Ndërsa mjeku Mërçellari, që është i VAKAT-it, vjen me kerr privat. Ma vonë, Behar Brenoli, që s’i ka dalë gjumi, e merr kerrin zyrtar edhe vjen në punë. Tre punëtorë të Krushevës me dy kerra të vijnë, kryetar, ditën e diel. Çka lyp Behar Brenoli të shtunë e të dielë me vozit kerrin e spitalit? Mos, kryetar, se 14 vjet ka hongër me ne edhe na ka tradhtue, ka me të tradhtue në tetor. Më kap për fjalë, ka me të tradhtue në tetor, ka me votue për PDK-në. Mos, se qasi bukëshkelës janë ata. Është marre, Dr. Mërçellari vjen me kerr privat, qaty kalon kerri, shoferi – edhe ju kam thënë, kam me ju thënë, se unë mas shpinës s’ju mëshoj – shoferi me teknikun vijnë në punë me kerr zyrtar, me kerr të QKMF-së. Ke thënë bajagi kam me i ndalë këto sende. Behari çdo ditë e shfrytëzon atë kerrin. Po kryetar, krejta i kam, që ta kallxoj foton, po s’kam kamerë. Qe, kryetar, qeky është mësuesi Behar, me çantë, që vjen në punë ditën e dielë në ora 10-11. Pa ta thënë këtu, kam me i qit në Facebook unë, veç kam qef një herë me ta thënë, mos me të ra thikë mas shpinës. Unë kam qef me t’i thonë krejta, edhe kam me i postue, se ia nisi fushata. Edhe qetu mbeta borxh, mos me dalë në replikë se ke thonë nuk i due shumë replikat: te Ujësjiellësi, veç edhe një fjali. 400 mijë euro që i ke ndarë. Më thaje, vitin e kaluar s’kanë punue pa pare, këtë vit do të punojnë se kanë fitue besimin tënd edhe janë fushatat. Në qoftë se ai i kryen punimet, edhe ti e presish shiritin, edhe dalish apllauga, edhe paret i ndajmë për me ia dhënë në mot, sikur - që në proces le të shkruhet, edhe incizimi – sikur përmbauesi t’i mori qeto pare, qysh t’i ka marrë, a ka me na akuzue kjo firma në mot, a ka me na lyp nëpër gjykata paret, se janë 400 mijë euro, nuk janë 40 mijë euro me ia falë, ose 400 euro. Po më vjen se pak po gutesh, kryetar. Mu po më doket – a ke marak edhe një mandat, unë kam me të votue, publikisht po të them kam me ta qit votën, veç mos i jep shumë zor me na çue nëpër gjykata. Një gjykatë ajo firma, një gjykatë... se qeto paret prapë kanë me t’i marrë, qeto 400 mijë eurot. Edhe këta të VV-së janë të prapë, shkojnë bash te uji t’i marrin paret. Faleminderit!

Uran Halimi: Ju përshëndes, të nderum delegatë! Tash prej fundit po lidhem, se krejt në fund e tha që këta të VV-së janë të prapë Artani. Na të prapë s’jemi, kush janë të prapë dihen. Edhe kryetari shumë më pëlqej kur tha katër vjet po shkojshin shumë shpejt. Kur na e tradhtove koalicionin, shumë më vijshin katër vjet, po po shkojshin shpejt, kryetar. Edhe është t’u të rrejt Artani që ke me i fitue zgjedhjet, që po të thotë. Mos i beso!

Munir Jonuzi: Kur një delegat flet për fshatin e tij, kjo do të thotë se po ndodh diskriminim ndaj fshatit të tij, ndërsa ai vetë është në listën e përjashtimit, pra objektiv i administratës aktuale. Po flas për dy projekte në Rapçën e Poshtme. Para një jave përfundoi një projekt për rrjetëzimin me pllaka. Kur e shikoni, vizualisht duket shumë mirë. Kemi një hapësirë të madhe në vendin ku më parë ishte një kanal, tani kemi hapësirë për parkim. Megjithatë, kur e shikoni më mirë projektin, do të vini re se pllakat tashmë po dalin jashtë vendit. Projekti përfundoi para një jave, dhe tash ka ngritje dhe ulje në terren. Është e çuditshme se si komisioni mbikëqyrës ka pranuar një projekt të tillë. Kemi një kanal, kemi një mur ku uji rrjedh nga ana tjetër e murit. Situata është që uji rrjedh në kanal pas murit, pastaj ka tokë, ujë dhe më pas kanal. Kjo kompani ishte serioze, tani po punon keq. Kjo ndoshta është politika e administratës që në Rapçë të kryhen projekte të dobëta. Drejtori i Urbanizmit pranon të gjitha projektet ose jep urdhër për pranimin e tyre, dhe si nuk do ta bëjë këtë kur kjo kompani çdo Ramazan e çon në iftar në Reçanë. Kështu veprohet në Rapçë, fshat që administrohet me diskriminim. Një dëshmi për këtë është edhe ndriçimi. Thashë që kompania ka ardhur në terren dhe ka ndërruar vetëm 5 llamba dhe asgjë më shumë. Në fshat kemi mbi 30 llamba të prishura. Do të jem i detyruar t’i publikoj të gjitha në Facebook dhe mos të thuhet më vonë se është politizim, por për shkak të lëndimit dhe sepse mendoj që fshati im është lënë pas dore.

Artan Loshaj: Kërkoj falje! Faleminderit që ma dhaje fjalën! Kryetar, atëherë po e mshelim krejt Komitetin. S'po vina, veç po nënshkruna, po i marrim paret. Unë të bëna me qëllim, për mos me thënë ti qe për fushatë po ma bën Artani para kamerave, unë ta bona një pyetje, të thashë s'kam qef unë para kamerave. Edhe të hënë kam me t'i bo këto pyetje, ma gjerë e ma gjatë, ama për afërsisht. Po bën vaki vdesim deri të hënë, nuk jemi këtu, kryetar. Është mirë nja dy-tri fjali bare me pika të shkurta me më thënë, çka ka me ndodhë me qet stadionin, çka ka me ndodhë më qeto, çka me ndodhë me nepotizmin, a është e vërtetë. Qeso sende, nja dy a tri fjali. Po që s'duesh, me zor s'un të qes, ama s'është mirë një delegatit – plus një anëtari të Komitetit – mos me i dhënë asnjë përgjigje prej dhjetë pyetjeve qe t'i bona.

Arijeta Skeraj: Atëherë, pasi kryetari i ka lënë të hënë përgjigjet, e mbyllim këtë KPF! Faleminderit!